



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 7964 Prot.

Tiranë, më 27 / 10 / 2014

UDHËZIM

Nr 48 , Datë 27 / 10 / 2014

PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 33, DATË 19.09.2014 "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PUBLIK E PRIVAT NË VITIN AKADEMIK 2014-2015 TË STUDENTËVE QË TRANSFEROJNË STUDIMET NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË TË CILËVE U ËSHTË HEQUR LICENCA"

Në mbështetje të nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit nr. 539, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave "Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë",

UDHËZOJ:

- I. Udhëzimi nr. 33 datë 19.09.2014 "Për procedurat e pranimit, në institucionet e arsimit të lartë publik e privat në vitin akademik 2014-2015 të studentëve që transferojnë studimet nga institucionet private të arsimit të lartë të cilëve u është hequr licenca" të ndryshojë si më poshtë:
 1. Pika 8 e Kreut IV të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
"Komisionet e vlerësimit dhe të ekuivalentimit të ngritur pranë IAL-ve publike kryejnë vlerësimin dhe ekuivalentimin e dosjeve të kandidatëve që rezultojnë të rregullta me qëllim ekuivalentimin e rezultateve individuale të secilit prej studentëve ndjekjes së programeve përkatës të studimit në IAL-të private të cilëve iu është hequr licenca, deri në orën 12:00 të datës 5 Nëntor 2014. Ekuivalentimi individual bëhet duke u bazuar në ekuivalentimin paraprak për çdo program studimi. "
 2. Pika 10 e Kreut IV të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
"Dekanatet e Fakulteteve bazuar në vendimin e komisionit të vlerësimit dhe ekuivalentimit, shpallin, brenda datës 5 Nëntor 2014, të dhënat për çdo kandidat, kreditet e ekuivalentuara, detyrimet dhe lëndët e pashlyera si dhe vitin në të cilin transferohet."

3. Pika 11 e Kreut IV të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
"Në periudhën nga data 5 Nëntor 2014 deri në datën 11 Nëntor 2014 bëhet regjistrimi i studentëve pranë sekretarive mësimore të Fakultetit përkatës dhe paguhet tarifa përkatëse. Shuma e derdhur nuk kthehet edhe në rastet kur kandidati largohet nga programi i studimit."
4. Pika 13 e Kreut IV të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
"IAL-të publike i dërgojnë MAS-it dhe AKP-së listën e studentëve të regjistruar, brenda datës 19 Nëntor 2014, me qëllim pajisjen e tyre me numër matrikullimi. Për të gjitha emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe do të kërkohet nga AKP-ja çregjistrimi i tyre."
5. Pika 1 e kreut VI të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
"Kandidatët aplikojnë pranë IAL-ve private nga data 25 Shtator deri në datën 7 Nëntor 2014."
6. Pika 4 e kreut VI të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
"Në IAL-të private aplikantët regjistrohen përfundimisht brenda datës 11 Nëntor 2014."
7. Pika 5 e kreut VI të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
IAL-të private i dërgojnë MAS-it dhe AKP-së brenda datës 19 Nëntor 2014, në rrugë postare, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjitha emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe do të kërkohet nga AKP-ja çregjistrimi i tyre."
8. Kreu VIII i Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
"AKP pajis studentët, për të cilët IAL-të publike dhe private kanë përcjellë listat me të dhënat përkatëse brenda afateve të parashikuara në këtë udhëzim, me numrin e matrikullimit, dhe ia komunikon atë me shkresë zyrtare IAL-së përkatëse brenda datës 19 Dhjetor 2014. Në rastet kur një student nuk mund t'i jepet numri i matrikullimit, AKP i kërkon IAL-së ta çregjistrojë atë. IAL çregjistron studentin brenda 10 ditësh kalendarike nga marrja e kërkesës zyrtare nga AKP."

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike dhe private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA


MINISTËR

